

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-144/11**

**Prishtinë, 18 prill 2012**

Në çështjen civile të:

**A.A.**

*Pala ankuese*

Kundër.

**M.S.K.**

*Paraqitësi i kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e kolegjit, Elka Filcheva - Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, duke vendosur lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPKK/D/A/62/2010 (*lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA38964*), të datës 25 shkurt 2010, pas shqyrtimit të mbajtur me 18 prill 2012, morri këtë:

## AKTGJYKIM

1. **Pranohet si e bazuar ankesa e A.A..**
2. **Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPKK/D/A/62/2010, i datës 25 shkurt 2010, për sa i takon lëndës së regjistruar me numrin KPA38964 dhe lënda kthehet për rishqyrtim.**
3. **Për shpenzimet e procedurës do të vendoset nga KPKK-ja.**

### **Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:**

Më 03 tetor 2007, M.S.K. (*tani e tutje "paraqitësi i kërkesës"*) kishte paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) për konfirmimin e së drejtës së tij pronësore mbi ngastrën nr. 1072 në sipërfaqe prej 32 ari e 53 metra katror, që përshkruhet si arë e klasës së 4-të në Rosul, Novosellë, Vushtrri. Paraqitësi i kërkesës ka "vërtetuar" se e drejta e tij pronësore ka të bëjë me palujtshmërinë private posedimi i së cilës është humbur si rezultat i rrethanave 98/99 në Kosovë dhe data e humbjes së posedimit ishte 16 qershor 1999.

M.K. ka paraqitur kërkesë si anëtar i familjes së ngushtë të Ž.K..

Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur në AKP dokumentet në vijim:

- fletën poseduese nr. 228, të lëshuar me 23 dhjetor 1992 nga Administrata Komunale për Gjeodezi në Vushtrri, që tregon se ngastra 1072 ishte regjistruar në emër Ž.M.K. (faqet 10 dhe 11 të lëndës së AKP-së);
- certifikatën e vdekjes së S.K., i lindur më 01 qershor 1921, që kishte vdekur më 18 dhjetor 1995, të lëshuar nga Vrnjačka Banja (faqja 9 e lëndës së AKP-së). Certifikata është e datës 22 dhjetor 1995. Ajo gjithashtu përmban të dhëna për prindërit e S.K., të cilët ishin Ž.K. dhe N.K.. Certifikata po ashtu tregon se bashkëshortja e S. ishte V.K., e gjinisë J.;
- certifikatën e vdekjes së Ž.K., i lindur në vitin 1883, që kishte vdekur më 02 maj 1970, të lëshuar nga e njëjta komunë (faqja 15 e lëndës së AKP-së). Certifikata është e datës 04 shkurt 2008. Certifikata vërteton se M.K. ishte babai i Ž.;
- dosja nuk përmban ndonjë dokument të shkruar që që dëshmon se S.K. ishte babai i paraqitësit të kërkesës M.K.. Sipas komentit të shkruar nga zyrtari i AKP-së (faqja 62 po aty), vëllai i paraqitësit të kërkesës, P.K. dhe nëna e tij V.K. kanë "konfirmuar" se M.K. është i biri i S.K.. Nuk ekzistojnë të dhëna se si është vërtetuar se këta janë vëllai dhe nëna e paraqitësit të kërkesës;

Faktet lidhur me procedurën para AKP-së:

Më 22 korrik 2008, zyrtarët e AKP-së kanë shkuar në vendin kur pretendohet se ndodhet prona dhe kanë vendosur një shenjë që tregonte se prona i ishte subjekt i kërkesës dhe se palët e interesuara duhej të paraqisnin përgjigjen e tyre brenda një muaji (*faqja 38 e lëndës së AKP-së*). Në raportin e saj të njoftimit (faqe 32 po aty), AKP-ja ka potencuar se ngastra kontestuese ishte një tokë e papunuar. Raporti thekson se prona ishte gjetur me ndihmën e banorëve vendas.

Më vonë në vitin 2009, më 02 nëntor 2009, AKP-ja e ka kryer njoftimin e dytë të ngastrës (*faqja 27 po aty*) duke vendosur një shenjë se prona ishte subjekt i kërkesës. Raporti i njoftimit i datës 02 nëntor 2009 (*faqja 19 po aty*) thekson se prona është arë e kultivuar, se është e uzurpuar dhe se pala përgjegjëse në kërkesë nuk gjendej aty. Më 04 dhjetor 2009, AKP-ja ka nxjerrë një raport të ri të njoftimit (*faqja 17 po aty*) për të konfirmuar se njoftimi i pronës së kërkuar ishte bazuar saktësisht në të dhënat kadastrale siç janë koordinatat ortofotografike dhe gps-i.

Ortofotografitë (faqja 18 po aty) tregojnë ngastrën dhe rrethinën e saj, shigjeta e vendosur tregon pikën në ngastër ku ndodhet shenja e AKP-së.

Më 09 dhjetor 2009, A.A. (*tani e tutje "pala përgjegjëse në kërkesë"*), ka paraqitur përgjigje duke pohuar se babai i tij F.A. është pronari i vërtetë i ngastrës së kontestuar. A.A. ka paraqitur përgjigjen pasi që F.A. nuk ishte në Kosovë (*faqja 45 po aty*). Nuk ka dokument të shkruar që dëshmonë se A.A. ka autorizim për të përfaqësuar F.A..

Për të mbështetur përgjigjen e tij ai ka paraqitur:

- fletën poseduese, të lëshuar nga komuna e Vushtrrisë më 19 Mars 2007 në emër të M.K. për ngastrën nr. 2138/2 më sipërfaqe prej 41 ari e 28 metra katror në Rosul (faqet 55-56 të lëndës së AKP-së);
- kontratën e shitblerjes, të lidhur me 04 prill 2007 ndërmjet M.K. si shitës dhe F.A. si blerës, lidhur me bartjen e pronës për ngastrën 2138/2 në Rosul (*faqe 68 po aty*);
- certifikatën nr. 7906-1/07, të lëshuar nga Zyra Kadastrale në Vushtri më 04 prill 2007, ku ceket se ngastra nr. 2138/2, e cila në fletën poseduese nr. 72 është në emër të M.K. (*faqe 65 po aty*).

Pala përgjegjëse në kërkesë ka pohuar se babai i tij e kishte blerë ngastrën 2138/2 dhe se shenja e njoftimit për ngastrën e kontestuar, që është 1072, ishte vendosur në pronën e tij, dmth. 2138/2.

Në bazë të dokumenteve aktuale, bazës së të dhënave në dispozicion dhe masave procedurale të ndërmarra në pajtim me nenin 11.3 (c) dhe (d) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, AKP-ja ka vërtetuar se paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar pronësinë e bartësit të së drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar dhe se provat e palës përgjegjëse në kërkesë nuk kanë të bëjnë me të. Në këtë drejtim, është marrë një vendim në favor të paraqitësit të kërkesës (*faqja 105/106 po aty, para 30 i vendimit të datës 25 shkurt 2010*). AKP-ja ka theksuar se kur Sekretaria Ekzekutive e ka kontaktuar palën përgjegjëse në kërkesë, ai

ka konfirmuar se kontrata e tij e shitblerjes ka të bëjë me një ngastër tjetër të tokës, por ka pohuar se shenja e notifikimit ishte vendosur në pronën e tij. AKP-ja me tej ka theksuar se raporti i njoftimit i përgatitur nga Sekretaria Ekzekutive ka treguar se shenja e njoftimit ishte vendosur në pronën e duhur. Vendimi grupor i datës 25 shkurt 2010 është pasuar nga një vendim individual, i datës 29 qershor 2010 (*faqja 95 po aty*). Vendimi nxjerrë në pah të drejtat e bartësit të së drejtës pronësore (dmth. Ž.K.) mbi pronën e kontestuar dhe **parasheh që çdo person që mund ta ketë uzurpuar atë, duhet ta lirojë atë brenda 30 viteve.**

Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesë me datën 05 tetor 2010 (f. 132 po aty). Më 02 nëntor 2010, ai ka paraqitur kërkesë në AKP për të marrë nën administrimin e saj pronën e kontestuar në pajtim me nenin 23.1 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079.

Vendimi i është dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë me datën 05 gusht 2011 (f. 135 po aty). Ai ka paraqitur ankesë në po të njëjtën ditë (f. 151). Ai pretendon se vendimi është i gabuar, sepse është bërë një njoftim jo i drejtë i pronës duke marrë parasysh se fshati Maxhunaj në Vushtrri është përfshirë në komasacion, gjë që ka rezultuar në krijimin e numrave të rinj të ngastrave.

Më 20 nëntor 2011, paraqitësi i kërkesës, tani pala përgjegjëse në ankesë ka thënë se kontrata e prezantuar e shitblerjes për ngastrën që është subjekt i lëndës së AKP-së 38964, nuk ka qenë e vlefshme (*f. 160 po aty*). Ai nuk ka dhënë sqarime rreth deklaratës së palës ankuese se ekzistojnë numra të rinj të ngastrave.

Më 21 dhjetor 2011, Kolegji i Apelit të GJS-së ka kërkuar nga AKP-ja që të sqaroj se si i kishte shfrytëzuar ekipi për njoftim i AKP-së të dhënat e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK-së) dhe se si kishte ardhur në përfundim se ngastra në të cilën ishte bërë njoftimi (*f. 18 po aty*) ishte ngastra 1072. AKP-ja po ashtu është dashur të ofrojë (nëse ishte e mundshme) një vlerësim të të dhënave të AKK-së lidhur me numrin e kësaj ngastre.

Më 02 shkurt 2012, Kolegji i Apelit të GJS-së kishte pranuar nga AKP-ja një përgjigje me emrin “memorandum ligjor”, lidhur me çështjet e sipërcekura. AKP sqaron se sipas hartës kadastrale (*f. 49 e lëndës së gjykatës*) ngastrat 1071 dhe 1072 ishin të ngjitura me njëra tjetrën. Në vitin 1989, si rezultat i komasacionit (*vendimi i datës 01 shkurt 1989, f. 51 po aty*) ngastra 1071 ishte bartur në ngastrën nr. 2138/2. Ngastra 2138/2 ka një sipërfaqe prej 41.28 ari, ndërsa ngastra 1071 ka një sipërfaqe prej 31.03 ari **dhe është shumë e mundshme që ngastra 1072 të jetë bartur në ngastrën 2138/2.** Kjo nuk është konfirmuar nga Drejtorati për Kadastër<sup>ii</sup> pasi që nuk ka pasur ndonjë vendim pas komasacionit. Këto fakte kanë qenë të panjohura për AKP-në. Si rezultat i kësaj, AKP-ja pohon se njoftimi i ngastrës 1072 ishte bazuar në të dhënat e vjetra të prezantuara nga Agjencioni Kadastral. AKP-ja nuk i ka të dhënat e përditësuara mbi statusin aktual dhe lokacionin e pronës së kërkuar. **AKP-ja arrin në përfundim se njoftimi i bërë me datën 02 nëntor 2009 (para 6 i memorandumit) nuk përputhet me statusin aktual dhe lokacionin e pronës së kërkuar.**

Përveç kësaj, raporti i datës 01 shkurt 2010 (*faqe 84-86 i lëndës së AKP-së*) përmban të dhëna se ngastra 2138/2 është objekt kontesti i një kërkesë të ndryshme, të paraqitur nga M.K. dhe se kërkesa e tij ende nuk është proceduar nga ana e AKP-së.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa është paraqitur brenda afateve ligjore siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-07, prandaj është e pranueshme. Pala ankuese pohon se prona e kontestuar është përfshirën në komasacion e cila ka rezultuar në numra të rinj të ngastrave dhe si rezultat i kësaj, njoftimi kishte qenë i gabuar. Këto deklarata kanë të bëjnë me vendimet e marra në bazë të vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike (neni 12.3 (b) po aty) dhe aplikimit të gabuar të së drejtës procedurale (neni 12.3 (a) po aty).

Neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 parasheh: “Pas pranimit të kërkesës, Sekretaria Ekzekutive duhet të njoftoj dhe dërgoj nga një kopje të kërkesës çdo personi, përpos paditësit, i cili aktualisht ushtron apo pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës dhe bën përpjekje të arsyeshme për të njoftuar çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në këtë pronë”.

Neni 11.3 (c) dhe (d) po aty parasheh që KKPK-ja ndërmerr masa të tjera procedurale (*të ndryshme nga ato të përmendura në nënparagrafët a,b dhe c*) që i konsideron të duhura për të përsheptuar vendimarrjen.

Neni 11.1 po aty parasheh që dispozitat ligjore të Ligjit mbi Procedurën Administrative janë të zbatueshme përshtatshmërisht në procedurën e KPKK-ës, përveç nëse parashihet ndryshe me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 dhe me Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5 mbi implementimin e Rregullores.

Neni. 39.2 i Ligjit mbi Procedurën Administrative – Ligji Nr. 02/L-28<sup>iii</sup> parasheh që pavarësisht dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, dhe për aq sa është e mundur, organet e administratës publike duhet t'i korrigojnë vetë kërkesat e palëve të interesuara, duke mos i paragjykuar interesat ligjore të palëve të interesuara. Kjo zgjidhje është manifestim i parimit të ligjshmërisë, siç përcaktohet në nenin 3.1 po aty, sipas të cilit organet e administratës publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë, brenda kufijve të kompetencave që u janë dhënë atyre dhe konform qëllimit për të cilat janë dhënë këto kompetenca. Një parim tjetër i parimit të ligjshmërisë i cili është relevant në rastin aktual është ai i formuluar në nenin 3.2 po aty, i cili thekson se organet e administratës publike sigurojnë zbatimin e akteve të tyre administrative, vendimeve të përshtatshme, siç janë ta zëmë aktet e KPKK-ës.

Neni 55 po aty gjithashtu parasheh se organi kompetent kërkon dhe njihet me të gjitha faktet të cilat janë të nevojshme për marrjen e vendimit përfundimtar, duke përdorur për këtë qëllim të gjitha metodat e të

provuarit të lejuara me ligj. Kjo zgjedhje sistematikisht rrjedh nga parimi i objektivitetit të procesit administrativ në pajtim me nenin 7.1 po aty: “Gjatë veprimtarisë administrative, organet e administratës publike marrin në konsideratë dhe u japin peshën që u takon të gjithë faktorëve që lidhen me një akt të caktuar administrativ”. Në po të të njëjtën linjë është neni 53.1 po aty i cili thekson se gjatë procedimit administrativ, nëpunësi që drejton procedimin merr në konsideratë të gjithë faktorët që kanë rëndësi për çështjen në fjalë dhe i jep secilit faktor vlerësimin e duhur si dhe parimin e objektivitetit si parim kryesor.

Në rastin aktual, KPKK-ja ka marrë vendimin e saj në kundërshtim me parimin e objektivitetit, pa marrë parasysh të gjithë faktorët relevant për nxjerrje të vendimit.

Ashtu siç është theksuar në “memorandumin ligjor” të datës 02 shkurt 2012, AKP-ja sqaron se ngastrat NN 1071 dhe 1072 ishin ngjitur më njëra tjetrën dhe se 1071 ishte përfshirë në komasacion dhe pastaj ishte bartur në ngastrën N 2138/2 dhe se ka shumë gjasa që pjesa e ngastrës 1072 ishte bartur në ngastrën 2138/2. Konkludimet e vetme faktike që mund të bëhen janë se numrat 1071 dhe 1072 nuk reflektojnë gjendjen aktuale kadastrale dhe se pas komasacionit të vitit 1989 janë krijuar ngastra të reja (ose nëpërmjet bashkimit ose nëndarjes); dmth. nga ajo çfarë kishin qenë në vitin 1989 ngastrat 1071 dhe 1072 janë bartur në njësi të reja kadastrale në numra të rinj. **Përkatesisht, e drejta pronësore mbi ngastrën 1072 është transformuar në të drejtën pronësore ose mbi tërë ngastrën e re ose mbi pjesët ideale të ngastrave tjera, varësisht nga fakti nëse 1072 i është dhënë vetëm emri i ri ose nëse është “absorbuar” (që është ajo që nënkuptohet në “memorandumin ligjor”) në dy apo më tepër njësi të ndryshme kadastrale.**

Në këtë drejtim KPKK-ja është dashur të hulumtojë gjendjen aktuale kadastrale (në pajtim me parimin e objektivitetit), që përfshinë historikun kadastral të tokës e cila njëherë ishte individualizuar si ngastra 1072 dhe sipas detyrës zyrtare (*në pajtim me parimin e ligjshmërisë – neni 3.1 në lidhje me nenin 39.2 po aty*) të korrigjojë kërkesën në mënyrë që të reflektojë gjendjen aktuale kadastrale të pronës së kërkuar dhe vullnetin e paraqitësit të kërkesës. Duke mos e bërë këtë, AKP-ja ka marrë vendim i cili nuk mund zbatohet, që paraqet një shkelje tjetër të parimit të ligjshmërisë (*shiko nenin 3.2 po aty*), dmth. në pjesën ku vendimi i AKP-së thekson se palët e treta duhet ta lirojnë pronën ai vendim i është i pazbatueshëm, nuk ka ndonjë identifikim të kufijve, nuk ka numër aktual kadastral për të përcaktuar se cilën pjesë të pronës palët e treta përkatëse do të duhej ta lironin. Me qëllim që vendimi të jetë zbatueshëm ai duhet t’i referohej një pjesë të tokës e cila është e dallueshme nga pjesët e afërme të tokës – me numër unik (*numrin aktual, që reflekton planin aktual. Në mungesë të qartësisë lidhur me kadastrin aktual, atëherë kufijtë dhe pikat e kufijve do të ishin të domosdoshme*). Në vijueshmëri të kësaj dispozitat ligjore të ligjeve administrative do të duhej të mirreshin në konsideratë. P.sh: në përputhshmëri me nenin 2, paragrafi 2.9 të Ligjit Nr. 2003/25 mbi Kadastrin (04 Dhjetor 2003), i plotësuar me Ligjin 02/L-96 (26 janar 2007, i zëvendësuar me Ligjin Nr. 04/L-013 (29 korrik 2011), d.m.th në fuqi dhe i aplikuar në kohën e procedimit para AKP-ës, ngastra kadastrale – toka

është e pronë e pandarë tokësore e krijuar nga kufijtë dhe pikat kufitare, që gjenden në një zonë kadastrale dhe e regjistruar në Kadastër si parcele toke me numër të veçantë.

Përveç kësaj, ndryshimet kadastrale të cilave iu referohet “memorandumi ligjor” krijojnë përshtypjen se kontesti rreth pjesës së tokës të përfshirë në ngastrën 1072 mund të ketë ndodhur shumë kohë para konfliktit të armatosur të vitit 1998/1999. Ajo që dihet deri me tani është se komasacioni është bërë në vitin 1989 dhe ai është përcjellë nga ndryshimi kadastral. Është e panjohur se kur brenda afatit kohor ndërmjet vitit 1989 dhe 1998 është bërë ndryshimi kadastral dhe nëse bartësi i së drejtës pronësore e kishte humbur posedimin si rezultat i komasacionit dhe/ose ndryshimit kadastral, apo si rezultat i konfliktit disa vite më vonë. Siç përcaktohet në Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 (neni 3.1), njëri prej kushteve për pranueshmërinë e kërkesës sipas këtij mekanizmi specifik procedural është që kërkesa të ketë lidhje me rrethanat që rezultojnë nga konflikti i armatosur dhe jo për shkak të paraqitjes së fakteve që nuk kanë të lidhje apo nuk rezultojnë nga konflikti.

Përveç kësaj, AKP-ja ka pasur të dhëna se një person tjetër M.K. kishte paraqitur kërkesë lidhur me ngastrën 2038/2, për të cilën AKP-ja mendonte se mund të përkonte/përputhej me 1072 dhe se **do të duhej të kihej parasysh** nëse dy procedurat nuk duhet të bashkoheshin (argumenti sipas nenit 11.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 – çështjet e përbashkëta të të provuarit).

Duke qenë i pazbatueshëm në natyrën e tij, vendimi i AKP-së ngjan me një akt të pavlefshëm administrativ (neni 91 në lidhje me nenin 92 (d) po aty), ai është nxjerrë në kundërshtim me procedurën e përcaktuar me Ligjin mbi Procedurën Administrative – në kundërshtim me parimet e përgjithshme të procedurës administrative. Një akt i pavlefshëm administrativ në hipotezën e pavlefshmërisë absolute nuk gjeneron ndonjë pasojë ligjore dhe nuk ka nevojë të revokohet – argumenti sipas nenit 93.1 të Ligjit mbi Procedurën Administrative. Mjafton që një akt i tillë të shpallet i pavlefshëm – argumenti sipas nenit 93.3 po aty. Megjithatë, duke marrë parasysh se Kolegji i Apelit të GJS-së zbaton instrumentet procedurale të parapara në Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 9 dhe në mënyrë subsidiare – dmth. përshtatshëmrisht Ligjin mbi Procedurën Kontestimore, Kolegji duhet të anulojë vendimin dhe t’ia kthejë atë AKP-së për rishqyrtim.

Gjatë procedurës së re, AKP-ja (*shiko ii*) duhet:

- të hulumtojë (sipas rastit, sa më shumë që të jetë e mundur) nëse posedimi i pronës ka humbur si rezultat i konfliktit të armatosur ose para kësaj si rezultat fakteve të tjera grupore dhe rrethanave;
- të korrigjojë kërkesën në mënyrë që të pasqyrojë gjendje aktuale kadastrale të pronës së kontestuar dhe vullnetin e palës;
- të kërkojë një dokument të shkruar që vërteton se S.K. është babai i M.K. me qëllim që të dihet nëse M.K. është “anëtar i familjes” të bartësit të së drejtë pronësore;

- të konsiderojë nëse kërkesa e paraqitur aktuale duhet të mos vendoset me kërkesën e M.K., e cekur në raportin (faqet 84-86 të lëndës së AKP – faqja 85, paragrafi i dytë nga lartë);
- të kërkoj dëshmi se A.A. posedon autorizimin për të përfaqësuar F.A. me qëllim të provimit të faktit nëse ka palë përgjegjëse në procedurë;
- dhe përfundimisht të analizojë nëse bartësi i të drejtës pronësore ka qenë pronari i vërtetë i drejtë (për shkak se konfirmimi i të drejtës pronësore është kërkuar, në përputhshmëri me kërkesën e parashtruar) i palujtshmërisë së kontestuar dhe nëse po nëse pala përgjegjëse ka kërkuar të njejtën pronë në vitin 2007, ashtu siq është kërkuar nga e njejta palë;

Sa i përket shpenzimeve të procedurës para GJS-së, pasi që është bërë anulimi dhe lënda është kthyer në procedurë të re administrative, shpenzimet e procedurës do të vendosën nga instanca e parë (*neni 465.3 i Ligjit mbi Procedurën Administrative*).

#### **Këshillë juridike:**

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

***Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX***

***Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it***

***Sylejman Nuredini, Gjyqtar***

***Urs Nufer, Referent i EULEX-t***

---

<sup>i</sup> Në dokumentet e ndryshme të lëndës, fshati quhet Novosellë (kërkesa) apo Maxhunaj (kontrata e shitblerjes e paraqitur nga pala përgjegjëse në kërkesë). Është e njohur për Gjykatën se këto referenca kanë të bëjnë me fshatin Novosellë e Magjunit.

<sup>ii</sup> Drejtorati për Gjeodezi dhe Pronë I Komunes së Vushtrisë, vendimi i datës 01.02.1989, kopja e f. 51 së dosjes së gjykatës)

<sup>iii</sup> Ligji nr. 02/L-28 I datës 22 korrik 2005